

Për Kryetarin




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE	
SKENDERAJ	
Nr.	
No.	04. 052/01.0003186/26
Data.	
Data.	21. 01. 2026



Komuna e Skenderajt

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Drejtoria e Arsimit / Department of Education

Raport i përgjithshëm i DKA-së për vitin 2025

Për punët dhe detyrat e kryera në periudhën janar - dhjetor 2025

Drejtoria e Arsimit gjatë periudhës njëvjeçare ka arritur me sukses t'i realizojë objektivat e planifikuara, të cilat kanë qenë të bazuara në planin e veprimit si dhe angazhime të shtuara në përmbushjen e kërkesave dhe obligimeve të paparashikuara.

Në komunën e Skënderajt gjithsej janë 29 institucione arsimore të nivelit parauniversitar, 24 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 3 të mesme të larta (2 nga to menaxhohen nga komuna e Skenderajt, ndërsa Qendra Kompetencës menaxhohet nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim për të rritur) dhe 2 institucione parashkollore.

27 institucione edukativo – arsimore të komunës sonë janë të pajisura me sisteme të kamerave. Gjithashtu, të gjitha këto institucione edukativo-arsimore (29 - shkolla) të nivelit parauniversitar kanë rrethoja.

Sektori për arsim

Gjysmëvjetori i parë për vitin shkollor 2024-2025 ka mbaruar më 24 dhjetor 2024. Drejtoria komunale e arsimit ka bërë analizën e suksesit të nxënësve për gjysmëvjetorin e parë të këtij viti shkollor.

Angazhime në përgatitjet për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2024-2025

Gjatë periudhës së pushimit dimëror janë bërë të gjitha përgatitjet higjiëno-teknike për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2024-2025.

Gjysmëvjetori i dytë për vitin shkollor 2024-2025 ka filluar më 08 janar 2025. Me rastin e fillimit të gjysmëvjetorit të dytë, shkollat janë vizituar nga zyrtarët e DKA-së, për të parë së afërmi përgatitjet që janë bërë edhe nga shkollat për fillimin e kësaj periudhe.

Gjithashtu, shkollat e komunës sonë, janë vizituar vazhdimisht edhe nga Inspektorët e Arsimit në Mitrovicë, të cilët janë kujdesur për mbarëvajtjen e procesit edukativo- arsimor.

Angazhime profesionale në zbatim të aktiviteteve të DKA

Ka vazhduar Vlerësimi i Performancës së drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 106/2020 të MASHTI.

Gjatë gjysmëvjetorit të dytë, zyrtarët e arsimit realizuan vizita nëpër të gjitha institucionet parashkollore, shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Qëllimi i vizitave ishte: mbarëvajtja e procesit mësimor, kontrollimi i ditareve, i përgatitjeve me shkrim, i librave amë, i planeve të drejtorëve, pastërtisë etj.

Zyrtarët e arsimit vazhdimisht kanë mbajtur takime në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor si dhe kanë marrë pjesë në trajnime dhe punëtori të ndryshme.

Në disa shkolla, Policia e Kosovës – regjioni i Mitrovicës, kanë mbajtur ligjërata për nxënës me temën: “Siguria në shkolla dhe dukuritë negative që ndodhin në shkolla në ditët e sotme”. Gjithashtu, për sigurinë në shkolla kanë mbajtur sesione informuese, debate, tryeza diskutimi në shkolla edhe FSK-ja së bashku me pedagogët/psikologët e shkollave tona në kuadër të planprogrameve mësimore.

Drejtoria e arsimit në Skënderaj, së bashku me Fakultetin e Edukimit dhe TOKA kanë ripërtërirë marrëveshjen e bashkëpunimit për trajnimin e mësimdhënësve në metodologjinë “Të nxënit përmes përvojës”, projekt i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe i mbështetur nga Komuna Skënderaj. Mbi 40 - mësimdhënës nga shkollat tona, në muajin dhjetor 2024 kanë përfunduar me sukses trajnimin mbi metodologjinë e të “Nxënit përmes Përvojës”, të cilët u pajisen me certifikata të akredituara nga MASHTI, gjithashtu prej tyre 25 – mësimdhënës janë certifikuar si mësimdhënës mentorë.

Në muajin janar 2025 kemi realizuar një takim me KFOR – CIMIC, të cilët na e prezantuan një ofertë / projekt “Të drejtat e fëmijëve”. Ky projekt i financuar nga Qeveria sllovene i realizuar në 26 - vende të botës, mundëson trajnimin e rreth 25 – mësimdhënësve të ciklit 1-5, 6-9 dhe asistentëve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të komunës sonë.

Edhe këtë vit, Shoqata Kosovare e Fizikës në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit organizuan garën e fizikës për nxënësit e klasëve të IX-ta, X-ta, XI-ta dhe të XII-ta. Nxënësit fitues në këto gara marrin pjesë në garat në nivel shteti.

Janë intervistuar kandidatët e konkurseve për mësimdhënës, pedagogë, sekretarë dhe punëtorë teknikë.

Shkollat: “Hamëz Jashari” Skënderaj, “Ahmet Delia” Skënderaj, “Shaban Jashari” Skënderaj, “Shotë Galica” Runik, “Skender Skenderi” Vajnikë, “Kuvendi i Drenicës” Abri e Poshtme, “Elena Gjika” Makërmal, “Abedin Rexha” Turiçec, “Idriz Barani” Klinë e Epërme, “Drenica” Polac, “Dëshmorët e Qyqavicës” Qirez dhe “Ismet Uka” Ticë janë pajisur me mjete mësimore në vlerë prej 49,900.00 € për lëndët: fizikë, kimi, biologji, gjeografi, informatikë dhe matematikë.

Me aktivitete të ndryshme dhe programe kulturo-artistike, në të gjitha shkollat e komunës sonë është kremtuar 17 Shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës.

Në garën e XXVI të fizikës 2025 në nivel shteti, të organizuar nga Shoqata Kosovare e Fizikës, morën pjesë nxënësit fitues të garës së fizikës në nivel komunal nga klasat e nënta, dhjeta, njëmbëdhjeta dhe dymbëdhjeta. Nxënësi i klasës së XI, në Gjimnazin “Hamëz Jashari”, Arifton Dragaj, zuri vendin e tretë në nivel shteti.

Kemi mbajtur një punëtori rajonale në Mitrovicë, me temën “Format e ekstremizmit të dhunshëm”.

Në bashkëpunim me MASHTI dhe Federatën e Sportit shkollor të Republikës së Kosovës, për herë të tretë është realizuar programi njëjavor i skijimit “Drejt malit 2025”. Pjesëmarrës ishin nxënësit e klasave të shtata të SHMU “Rifat Mëziu” Skënderaj (20 nxënës) dhe të shfmu “Azem Bejta” në Prekaz të Epërm (20 nxënës), të cilët qëndruan 5 – ditë në Brezovicë.

Në MASHTI kemi mbajtur një takim pune lidhur me Politikën për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes – Mundësia e zhvillimit të planeve komunale sipas kontekstit dhe nevojave të komunave.

Në të gjitha shkollat e komunës së Skënderajt, janë mbajtur aktivitete në shumta për nder të Epopesë së Lavdishme të UÇK-së dhe 7 Marsit – Ditës së Mësuesit.

Gjithashtu, për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, Drejtoria e Arsimit ka organizuar një ceremoni për ndarjen e mirënjohjeve dhe dhuratave për Veteranët e Arsimit, të cilët janë pensionuar gjatë vitit 2024-2025 dhe me nxënësit e mësimdhënësit më të suksesshëm me garat e organizuara gjatë vitit shkollor 2023-24.

Më 7 mars 2025, me rastin e Ditës së Mësuesit, DKA ka mbajtur edhe një takim me mësimdhënësit e shkollave tona, ku në bazë të vlerësimit të dosjeve janë përzgjedhur tre mësimdhënësit më të dalluar nga tri nivelet shkollore, të cilëve u janë ndarë edhe çmime.

Këtë vit shkollor MASHTI ka organizuar Olimpiadën e Përbashkët të Gjuhës Shqipe për nxënësit e klasave të IX në të gjitha shkollat e Kosovës. Kjo garë është mbajtur në tri faza. Garës në nivel

komunal i janë nënshtruar 80 – nxënës nga klasat e IX-ta dhe nxënësit fitues marrin pjesë në Olimpiadën e Përbashkët në nivel shteti. Për në fazën e tretë në nivel vendi u kualifikuan:

1. Artiola Ahmeti, SHFMU "Ismet Uka" Ticë I,
2. Blearta Haxhiu, SHMU "Rifat Mëziu" Skenderaj II,
3. Erblina Kadriu, SHFMU "Fehmi Rama" III.

Ka vazhduar vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara nga Ekipi Vlerësues në nivel komunal.

Në muajin mars kemi mbajtur një takim online me MASHTI në platformën ZOOM për mbajtjen e Testit PISA 2025. Po ashtu, gjatë këtij muaji kemi mbajtur një konferencë me temën "Ndikimi i PISA-s në informimin e politikave në Kosovë.

Janë kremtuar Ditët e Shkollave me aktivitete të ndryshme.

Kemi vazhduar memorandumit e bashkëpunimit me përfaqësuesit e Shoqatës Profesionale të Informaticientëve të Kosovës (ShPIK), për të organizuar "Javën e Orës së Kodimit" dhe zhvillimin e garave ndërkombëtare të Informatikës "Bebras Computing", ku janë trajnuar mbi 500 mësimdhënës të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët në fushën e informatikës dhe kodimit.

Me aktivitete të ndryshme vetëdijesuese, rekreative dhe sportive është shënuar Dita Ndërkombëtare e Personave me Sindromin DOWN.

Me aktivitete të ndryshme, në të gjitha shkollave është shënuar 22 Marsit – Dita Botërore e Ujit, e cila ka për qëllim të tërheqë sa më shumë vëmendjen tonë për kujdesin ndaj ujit të pijshëm.

Me nxënësit e shkollave tona janë mbajtur garat sportive të organizuara nga Federata e Sportit në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.

Komuna e Skënderajt, në këtë vit shkollor, ka ndarë bursa për 116 studentë të komunës sonë në vlerë 500 euro, vlera totale 58,000.00 euro dhe gjithashtu janë ndarë mjete edhe për transportin e nxënësve të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta si dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në vlerë total prej 32,000.00 Euro.

Janë realizuar aktivitete të ndryshme me rastin e Ditës Botërore të Autizmit.

Gjatë muajit prill, është realizuar trajnimi "Të Drejtat tona" i organizuar nga KFOR-i slloven për 50 – mësimdhënës të shkollave tona. Ky trajnim u realizua për 4 ditë me radhë duke i mbështetur mësimdhënësit tanë në zhvillimin profesional dhe në ngritje të cilësisë në arsim.

Në muajin prill, mësimdhënës nga shkollat tona e përfunduan me sukses trajnimin mbi metodologjinë e të Nxënit përmes Përvojës, i cili është organizuar dhe realizuar në partneritet me

Fakultetin e Edukimit, TOKA dhe Komuna Skënderaj si bashkëfinancuese. Kësaj radhe janë trajnuar edukatorë/et e klasave përgatitore, të cilët do t'i implementojnë metodologjitë inovative të fituara nga trajnimi në punën e tyre të përditshme me fëmijët.

23 Prilli – Dita Botërore e Librit është shënuar me aktivitete të ndryshme në shkollat tona. Disa shkolla mbajtën orë letrare e disa të tjera vizituan bashkë me nxënësit Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, me qëllim të ndërgjegjësimit të rinjve mbi rëndësinë e pazëvendësueshme që ka libri në zhvillimet socio-kulturore të një shoqërie dhe të një vendi.

Vazhdimisht janë mbajtur ligjërata, takime dhe punëtori të ndryshme nga Qendra e Karrierës.

MASHTI në bashkëpunim me DKA – Skenderaj dhe gjimnazin “Hamëz Jashari” në Skënderaj, kanë organizuar “Java e informimit në gjimnaze për orientim në karrierë”.

Në Olimpiadën e Kimisë në nivel rajonal, nxënësit e gjimnazit “Hamëz Jashari” në Skënderaj, u kualifikuan për në garën në nivel shteti, duke u renditur:

1. Altin Gashi (kl. XI) – vendi i parë,
2. Ajete Gashi (kl. XI) – vendi i dytë,
3. Sofie Thaçi (kl.XII) – vendi i dytë,
4. Ulpiana Murtezaj(kl. XII) – vendi i tretë.

Është bërë planifikimi për regjistrimin e nxënësve në IP, klasë të para dhe të dhjeta.

Me datat 12,13,14 dhe 15 maj, nxënësit e lindur në vitin 2009, pra 199 – nxënës nga shkollat tona i janë nënshtruar Testin Ndërkombëtar PISA.

Me 15 maj 2025, e përfunduan mësimin e rregullt nxënësit e klasave të dymbëdhjeta.

Edhe në këtë vit shkollor, Drejtoria komunale e arsimit në Skënderaj, gjatë muajit maj organizoi gara të diturisë në nivel shkolle dhe komune, në lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, matematikë, edukatë figurative dhe biologji. Garat janë organizuar për nxënësit e klasave të katërta, pesta, teta dhe të njëmbëdhjeta.

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e gjuhës angleze janë:						
Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Era	Lutfiu	"Ahmet Delia"	Skenderaj	IV	I
2	Valëza	Zabeli	"Shaban Jashari"	Skenderaj	IV	II
3	Toska	Geci	"Halit Geci"	Llaushë	IV	III

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e gjuhës angleze janë:						
Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Rejana	Vojvoda	"Ahmet Delia"	Skenderaj	V	I
2	Osiana	Gjinofci	"Shaban Jashari"	Skenderaj	V	II
3	Feroza	Smajli	"Abedin Rexha"	Turiçec	V	III

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e gjuhës angleze janë:						
Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Anita	Shabani	"Rifat Mëziu"	Skenderaj	VIII	I
2	Blinera	Ramadani	"Rifat Mëziu"	Skenderaj	VIII	II
3	Suela	Vojvoda	"Rifat Mëziu"	Skenderaj	VIII	II
4	Erisa	Nimani	"Shotë Galica"	Runik	VIII	III
5	Suela	Halili	"Rifat Mëziu"	Skenderaj	VIII	III

Më të dalluarit nga klasat e njëmbëdhjeta në lëndën e gjuhës angleze janë:						
Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Hajzer	Gashi	"Hamëz Jashari"	Skenderaj	XI	I
2	Suela	Ahmeti	"Hamëz Jashari"	Skenderaj	XI	II
3	Bledion	Ramadani	"Hamëz Jashari"	Skenderaj	XI	III

Sqarim: Vendi i dytë dhe tretë e ndajnë dy nxënës, për shkak të rezultatit të barabartë në pikë.

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Valëza	Zabeli	"Shaban Jashari"	Skenderaj	IV	I
2	Fjolla	Uka	"Ahmet Delia"	Skenderaj	IV	II
3	Yllka	Gashi	"Shaban Jashari"	Skenderaj	IV	III

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Eduarta	Hasani	"Vëllezërit Frashëri"	Qubrel	V	I
2	Era	Morina	"Shaban Jashari"	Skenderaj	V	II
3	Erëmirë	Hyseni	"Ahmet Delia"	Skenderaj	V	III

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Era	Konjuhi	"Rifat Mëziu"	Skenderaj	VIII	I
2	Hamëz	Hajdari	"Rifat Mëziu"	Skenderaj	VIII	II
3	Rinesa	Koca	"Drenica"	Polac	VIII	III

Më të dalluarit nga klasat e njëmbëdhjeta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Blediona	Gashi	"Anton Çetta"	Skenderaj	XI	I
2	Bleona	Gjinofci	"Anton Çetta"	Skenderaj	XI	II
3	Elisa	Behrami	"Hamëz Jashari"	Skenderaj	XI	III

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e matematikës janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Fjolla	Uka	"Ahmet Delia"	Skenderaj	IV	I
2	Leon	Jeta	"Shaban Jashari"	Skenderaj	IV	II
3	Elsa	Hiseni	"Abedin Rexha"	Turiçec	IV	III

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e matematikës janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Dajti	Goxhuli	"Ahmet Delia"	Skenderaj	V	I
2	Rejana	Vojvoda	"Ahmet Delia"	Skenderaj	V	II
3	Kron	Zabeli	"Shaban Jashari"	Skenderaj	V	III

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e artit figurativ - vizatim janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Vlera	Mangjoli	"Shaban Jashari"	Skenderaj	IV	I
2	Naile	Hoxhaj	"Ahmet Delia"	Skenderaj	IV	II
3	Suela	Koci	"Drenica"	Polac	IV	III

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e artit figurativ - vizatim janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Diar	Bajraj	"Shotë Galica"	Runik	V	I
2	Leon	Bajrami	"Shaban Jashari"	Skenderaj	V	II
3	Enuara	Gashi	"Ahmet Delia"	Skenderaj	V	III

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e artit figurativ - vizatim janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Vlera	Lushtaku	"Rifat Mëziu"	Skenderaj	VIII	I
2	Arinesa	Sylkaj	"Fehmi Rama"	Likoc	VIII	II
3	Erblin	Azemi	"Abedin Rexha"	Turiçec	VIII	III

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e artit figurativ - pikturë janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Aela	Gashi	"Ahmet Delia"	Skenderaj	IV	I
2	Hira	Beqiri	"Ahmet Delia"	Skenderaj	IV	II
3	Erisa	Xani	"Drenica"	Polac	IV	III

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e artit figurativ - pikturë janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Fatbardha	Shatri	"Shaban Jashari"	Skenderaj	V	I
2	Denis	Gjinofci	"Elena Gjika"	Makërmal	V	II
3	Tijara	Nuradini	"Ahmet Delia"	Skenderaj	V	III

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e artit figurativ - pikturë janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Vlera	Beqa	"Abedin Rexha"	Turiçec	VIII	I
2	Olti	Veliqi	"Drenica"	Polac	VIII	II
3	Elfije	Lushtaku	"Rifat Mëziu"	Skenderaj	VIII	III

Më të dalluarit nga klasat e njëmbëdhjeta në lëndën e biologjisë janë:

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla	Vendi	Klasa	Rezultatet
1	Ajete	Gashi	"Hamëz Jashari"	Skenderaj	XI	I
2	Hamit	Veliu	"Hamëz Jashari"	Skenderaj	XI	II
3	Rijana	Lushtaku	"Hamëz Jashari"	Skenderaj	XI	III

Sqarim: Vendi i tretë e ndajnë dy nxënës, për shkak të rezultatit të barabartë në pikë.

Si zakonisht, edhe këtë vit kemi organizuar shëtitjen njëditore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në kuadër të klasave të bashkangjitura dhe klasave të rregullta. Pjesë e kësaj shëtitjeje ishin rreth 70 pjesëmarrës, nxënës, prindër, mësime dhënë dhe zyrtarë komunalë, dhe në fund të shëtitjes u shtrua një drekë për të gjithë. Ky aktivitet është organizuar nga viti 2005 dhe qëllimi i tij është socializmi dhe argëtimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

1 Qershorin – Ditën e Fëmijëve e kemi shënuar së bashku me shkollat me aktivitete të ndryshme kulturo-argëtuese dhe sportive.

Është mbajtur ceremonia e ndarjes së certifikatave për mësime dhënë që morën pjesë në trajnimin për projektin “ Të drejtat tona”.

Është bërë inaugurimi i Institucionit të ri parashkollor në Skënderaj, me një hapësirë moderne, e cila ka kapacitet për 120 fëmijë. Ky institucion është realizuar në mbështetje të Bashkimit Evropian.

Është zhvilluar aktiviteti Hiking “Drejt malit” me nxënësit më të suksesshëm në gara të ndryshme të shkollave të mesme të ulëta të komunës së Skënderajt, i organizuar nga MASHTI, Ministria e Kulturës, Federata e Sportit Shkollor dhe Drejtoria e Arsimit në Skënderaj. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 80 nxënës të shkollave tona dhe 8 mësimdhënës të kulturës fizike.

Më 06 qershor 2025 është mbajtur Testi i Maturës Shtetërore për nxënësit e klasave të XII-ta të shkollave të mesme të larta të komunës sonë. Testimit i janë nënshtruar rreth 516 – nxënës dhe kalueshmëria e këtij testi është 71.12 %.

Të dhënat për rezultatet e testit të Maturës:

	1. Numri i nxënësve të cilët kanë mbaruar klasën e 12-të	2. Numri i nxënësve me rezultatu mbi pragun e kalueshmërisë në testin e maturës shtetërore klasa e 12	3. Numri i nxënësve vajza të cilat kanë mbaruar klasën e 12-të	4. Numri i nxënësve vajza me rezultate mbi pragun e kalueshmërisë në testin e maturës shtetërore klasa e 12-të
Gjimnazi “Hamëz Jashari	147	139	89	84
IAAP “Anton Çetta”	200	128	136	97
Qendra e Kompetencës	169	100	38	37
Gjithsejt	516	367	263	218

Me aktivitete të ndryshme kulturo-artistike e sportive, në shkolla u shënuar Dita e Çlirimit të Skënderajt.

Vazhdimi i vizitave sistematike të QKMF-së në të gjitha shkollat e komunës së Skenderajt.

Me 23 qershor 2025, e përfunduan mësimin e rregullt nxënësit e klasave 1 – 8, të të gjitha shkollave të komunës sonë.

Sipas raporteve përmbledhëse të drejtorëve të shkollave, të cilat i dorëzojnë në DKA dy herë në vit dhe në bazë të vizitave të zyrtarëve të arsimit, pas përfundimit të vitit shkollor 2024 -2025, më 23 qershor 2025, janë kryer të gjitha punët administrative dhe statistikore nga ana e mësimdhënësve në ditarë si dhe janë mbajtur mbledhjet me prindër.

Gjithashtu, gjatë muajit qershor është mbajtur Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta. Ky test është realizuar në dy ditë 27.06.2025, në 4 qendra të testimit dhe i janë nënshtruar rreth

591 – nxënës. Rezultati i arritur në Testin e Arritshmërisë për klasat e 9-ta është 48.7, ndërsa rezultati i arritur nga vajzat në testin e arritshmërisë është 49.6.

Kanë vazhduar projektet për:

- Renovimin e objekteve shkollore,
- Furnizimin me pajisje, kabinete dhe laboratore shkollore,
- Pasurimin e bibliotekave të shkollave me tituj të rinj,
- Furnizimin me kabinete për informatikë,
- Rregullimin e poligoneve sportive (shfmu „Ahmet Delia“ në Skenderaj dhe së shpejti në shfmu „Shaban Jashari“ dhe shfmu „Elena Gjika“) dhe
- Rregullimin e rrethojave dhe ndriçimit të shkollave.

Buxheti i Kosovës për vitin 2026 - Komuna

Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2026

Kodi	Kodi	Kodi	Komuna	Programi	Nonprogrami	Parsishkrimi	Shall	Paga dhe Shërbime	Mallorat dhe Shërbime	Shpenzimet konvencionale	Shpenzimet kapitale dhe Transferte	Financimi Publik	Financimi	Total	Total	Total
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n	o	p	q
100				Arsimi dhe shkenca		Total Shpenzimet	813	7,871,200	845,727	61,580	100,000	33,333		8,311,854	8,124,848	8,362,413
						Grantet Qeveritare	883	7,871,200	615,545	61,580	100,000	33,333		8,791,630	8,881,848	8,837,413
						Të Hyrës Vetëzakade			230,196					230,196	255,399	315,603
						Financimi i Jashtëm										
						Financimi nga Huamarrja										
5215	0100			Administrata		Total Shpenzimet	14	24,300	25,000		100,000			124,300	0	0
						Grantet Qeveritare	14	24,300	25,000		100,000			124,300	0	0
						Të Hyrës Vetëzakade										
						Financimi i Jashtëm										
						Financimi nga Huamarrja										
5210	0111			Arsimi parashkollor		Total Shpenzimet	55	175,000	194,472	6,000				375,472	545,321	545,910
						Grantet Qeveritare	55	175,000	194,472	6,000				375,472	545,321	545,910
						Të Hyrës Vetëzakade										
						Financimi i Jashtëm										
						Financimi nga Huamarrja										
5300	0012			Arsimi filior, i mesëm i ulët		Total Shpenzimet	609	6,255,000	581,243	45,500		93,333		6,935,082	7,405,330	7,362,757
						Grantet Qeveritare	609	6,255,000	476,448	45,500		93,333		6,830,082	6,915,330	7,879,757
						Të Hyrës Vetëzakade			104,800					104,800	114,091	181,603
						Financimi i Jashtëm										
						Financimi nga Huamarrja										
5400	0022			Arsimi i mesëm i lartë		Total Shpenzimet	129	1,167,000	85,000	10,000				1,262,000	1,364,409	1,334,163
						Grantet Qeveritare	129	1,167,000	85,000	10,000				1,262,000	1,344,409	1,334,163
						Të Hyrës Vetëzakade										
						Financimi i Jashtëm										
						Financimi nga Huamarrja										
Total shpenzimet për 38 Komuna						Total Shpenzimet	0	0	0	0	0	0		0	0	0
						Grantet Qeveritare	0	0	0	0	0	0		0	0	0
						Të Hyrës Vetëzakade	0	0	0	0	0	0		0	0	0
						Financimi i Jashtëm	0	0	0	0	0	0		0	0	0
						Financimi nga Huamarrja	0	0	0	0	0	0		0	0	0

Njëzet e gjashtë shkolla janë të pajisura me kabinete të informatikës, ndërsa një shkollë nuk e ka funksional për shkak të mungesës së hapësirës për kabinet.

Nga 28 institucione arsimore, vetëm 2 shkolla nuk posedojnë kamera, ndërsa të tjerat janë të pajisura me kamera.

Të gjitha shkollat në komunën tonë kanë rrethoja.

Të gjithë drejtorët e shkollave raportojnë në DKA për çdo muaj dhe çdo gjashtë muaj për ecurinë e procesit edukativo arsimor si dhe në fund të vitit e dërgojnë raportin përmbljedhës.

Drejtori i DKA është anëtar i KKSB-së dhe raporton në çdo takim i cili organizohet nga zyra e kryetarit, (përafërsisht janë mbajtur 4 takime brenda vitit).

Vetëm shkolla profesionale Qendra e Kompetencës posedon punëtori me material shpenzues.

Të gjitha shkollat në komunën e Skenderajt posedojnë biblioteka të pajisura me tituj librash dhe lektyrash.

Të gjitha shkollat janë të pajisura me orendi të domosdoshme dhe janë funksionale.

Gjashtë shkolla të komunës së Skenderajt janë të pajisura me projektorë në secilën klasë.

Sistemin e energjisë solare nuk e posedojnë asnjë nga shkollat tona.

11 shkolla janë të pajisura me sallë të edukatës fizike me mjete dhe pajisje.

Të gjitha shkollat kanë masa të kursimit të energjisë elektrike, ndërsa nuk kemi asnjë shkollë të pajisur me sistemin gjeotermal.

Numri i mësimdhënësve mbështetës dhe asistentëve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e komunës së Skenderajt është 17.

Në Qendrën e Kujdesit dhe Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme me bazë në komunitet në shfmu “Enver Haliti” në Lubovec janë të përfshirë 12 fëmijë të grupmoshës 3 deri 6 vjeç.

Në dy institucionet parashkollore “Nëna Zahide” dhe “Sala dhe Hamit Jashari” në Skënderaj e vijnë kopshtin gjithsej 46 – fëmijë të grupmoshës 0 – 3 vjeç.

Ndërsa, në paralelen e ndarë të Institucionit parashkollor “Nëna Zahide” në Bajë janë të përfshirë 12 fëmijë të grupmoshës 0 deri 3.

Drejtoria e Arsimit në Skenderaj, në fund të çdo viti mësimor bën vlerësim të përgjithshëm të ecurisë dhe performancës së procesit edukativo-arsimor për të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke analizuar suksesin e nxënësve për rezultatet e përgjithshme dhe duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Suksesi i nxënësve për vitin shkollor 2024/25 në arsimin fillor (1-5) në Komunën e Skenderajt

Në arsimin fillor (klasa 1-5) nga raportet e shkollave fillore për suksesin e nxënësve për vitin shkollor 2024/25 shihet se në 23 shkolla fillore të Komunës së Skenderajt, në përfundim të gjysmëvjetorit të dytë me sukses janë 2698 nxënës.

Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas klasave

- Në klasën e parë (I) janë të regjistruar 540 nxënës
- Në klasën e dytë (II) janë të regjistruar 513 nxënës
- Në klasën e tretë (III) janë të regjistruar 538 nxënës
- Në klasën e katërt (IV) janë të regjistruar 517 nxënës
- Në klasën e pestë (V) janë të regjistruar 590 nxënës

Pra, në arsimin fillor prej klasës I-V janë të regjistruar 2965 nxënës

Suksesi i nxënësve në arsimin fillor për vitin shkollor 2024/25

Prej nxënësve të vlerësuar:

2,134 nxënës ose 79.10 % janë me sukses të shkëlqyeshëm
365 nxënës ose 13.53 % janë me sukses të shumë mirë
218 nxënës ose 5.37 % janë me sukses të mirë
65 nxënës ose 1.26 % janë me sukses të mjaftueshëm
Gjithsej me sukses kalues janë 2615 nxënës ose 99.2%.
20 nxënës ose 0.80 % janë të panotuar

Nota mesatare e klasëve

Klasa e I (4.75)

Klasa e II (4.64)

Klasa e III (4.62)

Klasa e IV (4.58)

Klasa e V (4.54)

Nota mesatare e nivelit I-V (4.63)

Në nivelin fillor, për vitin shkollor 2024-2025, notën më të lartë e ka arritur klasa e I-rë, ndërsa nota më e ulët është në klasën e V-të

KRAHASIMI I SUKSESEVE PËR VITET 2023-2024 DHE 2024-2025

(Nota mesatare dhe mungesat e nxënësve për nivelin fillor)

Suksesi i nxënësve

Në tabelarin e ilustruar paraqitet krahasimi i suksesit pozitiv dhe negativ të nxënësve për gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2023/2024 me gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2024/2025.

Suksesi i nxënësve 2023-24		Suksesi i nxënësve 2024-25	
Suksesi pozitiv	99.45 %	Suksesi pozitiv	99.20 %
Të panotuar	0.55 %	Të panotuar	0.80 %

Suksesi pozitiv i nxënësve në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2023-24 krahasuar me vitin shkollor 2024-25, shihet se në këtë vit suksesi pozitiv i nxënësve është më i ulët se i vitit të kaluar.

Nota mesatare

Klasa	Nota mesatare	
Gjysmëvjetori i II-të	2023/2024	2024/2025
I	4.83	4.75
II	4.78	4.64
III	4.59	4.62
IV	4.60	4.58
V	4.56	4.54
Nota mesatare e nivelit (I-V)	4.68	4.63

Nota mesatare e e gjysmëvjetorin të dytë të vitit 2023/2024 është më e lartë se në gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2024/2025

Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2024/25 në arsimin e mesëm të ulët në Komunën e Skenderajt

Në arsimin e mesëm të ulët (klasa 6-9) nga raportet e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta për suksesin dhe mungesat e nxënësve për vitin shkollor 2024/25, shihet se në 22 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Skenderajt, në përfundim të gjysmëvjetorit të dytë me sukses janë 2,242 nxënës.

Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët sipas klasëve

- Në klasën e gjashtë (VI) janë të regjistruar 526 nxënës
- Në klasën e shtatë (VII) janë të regjistruar 571 nxënës
- Në klasën e tetë (VIII) janë të regjistruar 554 nxënës
- Në klasën e nëntë (IX) janë të regjistruar 591 nxënës

Pra, në arsimin e mesëm të ulët prej klasës VI-IX janë të regjistruar 2242 nxënës.

Suksesi i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2024/25

Suksesi i nxënësve pozitiv, negativ dhe të panotuar në nivelin e mesëm të ulët për gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2024-2025.

Prej nxënësve të vlerësuar:

545 nxënës ose 24.31 % janë me sukses të shkëlqyeshëm
715 nxënës ose 31.89% janë me sukses të shumë mirë
645 nxënës ose 28.77 % janë me sukses të mirë
202 nxënës ose 9.01 % janë me sukses të mjaftueshëm
Gjithsej me sukses pozitiv janë 2,107 nxënës ose 93.98%.
104 nxënës ose 4.64 % janë më nga një, dy, tri (notë të dobët)
31 nxënës ose 1.38 % janë të panotuar

Nota mesatare e klasëve

Klasa e VI	(4.08)
Klasa e VII	(3.58)
Klasa e VIII	(3.60)
Klasa e IX	(3.45)
Nota mesatare e nivelit VI-IX	(3.68)

Për nivelin e mesëm të ulët në gjysmëvjetorin e parë për vitin shkollor 2024-2025, notën më të lartë e ka arritur klasa e VI-të, ndërsa nota më e ulët është në klasën e IX-të.

KRAHASIMI I SUKSESEVE PËR VITET 2023-2024 DHE 2024-2025

(*Nota mesatare dhe mungesat e nxënësve për nivelin e mesëm të ulët*)

Suksesi i nxënësve

Në tabelarin e ilustruar paraqitet krahasimi i suksesi pozitiv dhe negativ të nxënësve për gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2023/2024 me gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2024/2025.

Suksesi i nxënësve 2023-24		Suksesi i nxënësve 2024-25	
Suksesi pozitiv	89.1%	Suksesi pozitiv	93.98%
Suksesi negativ	10.9%	Suksesi negativ	6.02%

Suksesi pozitiv i nxënësve në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2023-24 me vitin shkollor 2024-25, shihet se në këtë vit suksesi pozitiv i nxënësve është më i lartë se i vitit të kaluar.

Nota mesatare

Klasa

Nota mesatare

Gjysmëvjetori i II-të	2023/2024	2024/2025
VI	4.02	4.08
VII	3.90	3.58
VIII	3.52	3.60
IX	3.50	3.45
Nota mesatare e nivelit VI-IX		3.68
		3.73

Nota mesatare e gjysmëvjetorit të dytë të vitit 2024/2025 është më e lartë për 0.03 sesa në gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2023/2024.

Suksesi i nxënësve në gjysmëvjetorin e dytë, 2024/2025 në arsimin e mesëm të lartë

Në arsimin e mesëm të lartë (klasa X-XII) nga raportet e shkollave të mesme të larta për suksesin e nxënësve për vitin shkollor 2024/25 shihet se në tri (3) shkollat e mesme të Komunës së Skenderajt, numri i nxënësve është 1643.

Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë sipas klasave është si vijon:

- Në klasën e dhjetë (X) kanë vijuar mësimin 588 nxënës
- Në klasën e njëmbëdhjetë (XI) kanë vijuar mësimin 542 nxënës
- Në klasën e dymbëdhjetë (XII) kanë vijuar mësimin 513 nxënës

Në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2024/2025, suksesi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë është si vijon:

Prej nxënësve të vlerësuar në gjysmëvjetorin e dytë:

577 nxënës ose 35.12 % janë me sukses të shkëlqyeshëm
353 nxënës ose 21.49 % janë me sukses të shumë mirë
339 nxënës ose 20.63 % janë me sukses të mirë
109 nxënës ose 6.63 % janë me sukses të mjaftueshëm
Gjithsej me sukses pozitiv janë 1378 nxënës ose 83.87 %
201 nxënës ose 12.23 % janë me nga një, dy, tri e më shumë nota dobëta
Gjithsej me sukses negativ janë 201 nxënës ose 12.23 %
64 nxënës ose 3.90 % janë të panotuar

Orët e planifikuara dhe të realizuara për vitin shkollor 2024-2025

Nr.	Emri dhe mbiemri i drejtorit të shkollës	Emri i shkollës	Gjithsej numri i orëve të planifikuara sipas kalendarit shkollor në të gjitha institucionet ISCED 1 2 dhe 3	Gjithsej numri i orëve të realizuara sipas kalendarit shkollor në të gjitha institucionet ISCED 1 2 dhe 3
1	Halil Thaqi	SHFMU "Skender Skenderi" Vajnikë	8,380	8,380
2	Rrahim Dervishaj	SHFMU "Shotë Galica" Runik	23,630	23,605
3	Fitim Gashi	SHF "Shaban Jashari" Skenderaj	19,260	19,235
4	Shefqet Geci	SHFMU "Halit Geci" Llaushë	16,920	16,695
5	Bekim Buliqi	SHFMU "Vëllezërit Frashëri" Çubrel	9,036	9,028
6	Shaban Lushtaku	SHFMU "Ilir Lushtaku" Prekaz i Poshtëm	8,410	8,224
7	Enver Mulaj	SHF "Ahmet Delia"-Skenderaj	12,354	12,048
8	Milaim Koci	SHFMU "Drenica" Polac	25,681	25,671
9	Sami Beqiri	SHFMU "Pavarësia" në Krasaliq	9,091	9,067
10	Mimoza Bimbashi - Islami	SHFMU "Kuvendi i Drenicës" Abri e Poshtme	8,398	8,353
11	Hamide Abazi	SHFMU "Ismet Uka" Ticë	9,064	8,948
12	Arsim Jusufi	SHFMU "Fehmi Rama" Likoc	9,187	8,992
13	Hasan Ademi	SHFMU "Bashkim Sadiku" Tushilë	8,530	8,326
14	Abedin Abazi	SHFMU "Migjeni" Kllodernicë	8,412	8,412

15	Sylejman Haxha	SHFMU "Ismet Rrahmani" Aqarevë	8,380	8,380
16	Sami Tahiraj	SHFMU "Idriz Barani" Klinë e Epërme	16,557	16,483
17	Gisela Shala	Gjimnazi "Hamëz Jashari" Skënderaj	15,761	15,385
18	Avni Aliu	SHFMU "Faik Dragaj" Leqinë	12,488	12,488
19	Halil Sadiku	SHFMU "Enver Haliti" Lubavec	9,089	9,026
20	Anton Istogu	SHFMU "Elena Gjika" Makërmal	8,930	8,905
21	Amir Ferati	SHFMU "Dëshmorët e Qyqavicës" Qirez	13,399	13,335
22	Arben Zabeli	SHFMU "Malush Ahmeti" Rezallë	9,102	8,976
23	Fadil Beqa	SHFMU "Abedin Rexha" Turiçec	29,207	29,145
24	Agron Istogu	IAAP "Anton Çetta" Skenderaj	35,904	35,815
25	Ajet Ajeti	SHFMU "Azem Bejta" Prekaz i Epërm	15,952	15,785
26	Fatmir Hoti	SHMU "Rifat Mëziu" Skënderaj	32,049	31,957
	Totali		383,171	380,664

Klasë	Gjinia	Skenderaj
Grupa 1-2	Mashkull	12
	Femër	14
	Gjithsej	26
Grupa 2-3	Mashkull	29
	Femër	19
	Gjithsej	48
Grupa 3-4	Mashkull	39
	Femër	33
	Gjithsej	72
Grupa 4-5	Mashkull	36
	Femër	26
	Gjithsej	62
Grupa 5-6 - Parashkollor(Çerdhe)	Mashkull	30
	Femër	27
	Gjithsej	57
Grupa 5-6 - Parafillor	Mashkull	182
	Femër	175
	Gjithsej	357
Klasa 1	Mashkull	240
	Femër	216
	Gjithsej	456
Klasa 2	Mashkull	252
	Femër	259
	Gjithsej	511
Klasa 3	Mashkull	275
	Femër	263
	Gjithsej	583
Klasa 4	Mashkull	269
	Femër	249
	Gjithsej	518
Klasa 5	Mashkull	304
	Femër	288
	Gjithsej	592
Klasa 6	Mashkull	274
	Femër	252
	Gjithsej	526
Klasa 7	Mashkull	322
	Femër	249
	Gjithsej	571
Klasa 8	Mashkull	306
	Femër	248
	Gjithsej	554
Klasa 9	Mashkull	298
	Femër	293

	Gjithsej	591
Klasa 10	Mashkull	320
	Femër	268
	Gjithsej	588
Klasa 11	Mashkull	276
	Femër	268
	Gjithsej	588
Klasa 12	Mashkull	278
	Femër	235
	Gjithsej	513
Gjithsej		7122

Gjinia	Skenderaj
Mashkull	3742
Femër	3380
Gjithsej	7122
Nr fëmijeve me NV deri në klasën e 12	49

Mësimdhënës	Gjithsej	668
	Mashkull	268
	Femër	382

Numri i mësimdhënësve në institucionet arsimore të nivelit ISCED 0 1 2 3 në shkollat e komunës së Skënderajt është 668.

Numri i kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta (NV) është 19.

Në muajin korrik, në MASHTI kemi dërguar kërkesat e shkollave për pajisje me tekste mësimore, sipas katalogjeve, pasi edhe këtë vit shkollor MASHTI i ka subvencionuar prindërit për blerjen e teksteve mësimore.

Kemi shpallur konkurse të rregullta për pranimin me kohë të kuadrit edukativo-arsimorë, duke u bazuar në tabelat e angazhimeve dhe kërkesat nga shkollat për plotësimin me kuadër edukativo-arsimor.

Më 07 korrik 2025 është shpallur konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjinnaz dhe IAAP për vitin shkollor 2025-2026.

Në vazhdimësi kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit me organizatën TOKA për zbatimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me rritjen e cilësisë në arsim, vullnetarizëm, aktivizim qytetar, fuqizim të rinisë etj.

Më 18 gusht 2025 është shpallur konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në IAAP dhe QKS, për vitin shkollor 2025-2026, afati i dytë.

Drejtorët e të gjitha shkollave kanë raportuar në Drejtorinë e Arsimit për çdo muaj dhe në fund kanë dërguar raportin përmbljedhës për punët dhe detyrat e realizuara gjatë një viti shkollor.

IAAP “Anton Çetta” në Skënderaj, në konkurrencë me shkolla nga 6 vende të Ballkanit Perëndimor, është kualifikuar për një projekt madhor në fushën e Teknologjisë së Informacionit, të financuar nga RCF dhe German Development Bank. Ky projekt, me vlerë mbi 300,000 €, është një mundësi e jashtëzakonshme për të rinjtë tanë, që do të përfitojnë nga kushtet më të mira, mësimdhënie moderne dhe perspektivë më të gjerë për të ardhmen.

Sistemimi i mësimdhënësve dhe shpërndarja e orëve mësimore të mësimdhënësit të cilët rrezikoheshin si tepriçë teknologjike.

Gjatë pushimit veror janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura për fillimin e vitit shkollor 2025-2026. Viti i ri shkollor filloi më 01 shtator 2025 në të gjitha shkollat e komunës sonë, sipas kalendarit të MASHTI.

Ka vazhduar trajnimi i mësimdhënësve të komunës sonë “Të nxënësve përmes përvojës” i organizuar nga TOKA dhe Fakulteti i Edukimit – Prishtinë.

Takim rreth projektit për ngritje të vetëdijes së komunitetit për fatkeqësitë natyrore, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës. Ky projekt është implementuar nga Banka Botërore. AME është përfituese e projektit të BE-së “Ngritja e njohurive për zvogëlim të rrezikut, parashikimi i bazuar në ndikim dhe paralajmërimi i hershëm në Kosovë.

SBASHK ka organizuar trajnimin për mësimdhënës në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Takim me përfaqësuesit e Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nëna Tereze” në Mitrovicë, në lidhje me bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet komunës sonë dhe kësaj qendre, e cila na ofron shërbime dhe mbështetje të vazhdueshme për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Në SIA kemi dërguar raportet e shkollave për Vlerësimin e Brendshëm të shkollave dhe Vetëvlerësimin e drejtorëve. Pesë drejtorëve të shkollave u është vlerësuar performanca dhe u është vazhduar mandati edhe për katër vite.

Kemi realizuar takim pune në MASHTI, me qëllim të shqyrtimit të procesit të hartimit të planeve, të iniciuara muaj më parë.

Me aktivitete të shumta kulturo-artistike dhe sportive, në të gjitha shkollat e komunës sonë është kremtuar 28 Nëntori – Dita e Flamurit dhe e Pavarësisë së Shqipërisë.

Po ashtu më 28 Nëntor 2025, në ambientet e Institucionit të ri parashkollor është mbajtur ceremonia solemne me rastin e zbulimit të busteve të heronjve Sala e Hamit Jashari, emrin e të cilëve e bart ky institucion.

Me rastin e 3 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi Ndryshe, kemi organizuar një aktivitet me lojëra sportive dhe këtyre nxënësve u kemi dhuruar lodra dhe dhurata.

Edhe këtë vit shkollor, Shoqata Matematike e Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit – Skënderaj, kanë organizuar garën e matematikës në nivel komunal (OMK XVII), për nxënësit e klasave të shtata, teta, nënta, dhjeta, njëmbëdhjeta dhe dymbëdhjeta të shkollave tona. Nxënësit fitues nga kjo garë marrin pjesë në OMK në nivel shteti.

Ekipi komunal për parandalimin e braktisjes së shkollës kanë vizituar dy familje, fëmijët e të cilave kanë tentuar ta braktisin shkollën dhe kanë arritur që t'i kthejnë prapë në shkollë. Për vitin shkollor 2024-2025 nuk ka raportime për braktisje të mësimit nga ana e nxënësve nga asnjë nivel.

Janë organizuar dhe mbajtur garat sportive regjionale në futsall me nxënësit e tri komunave të përprehura nga Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike, DKA dhe DKRS – Skënderaj.

Në muajin dhjetor kemi realizuar takim me zyrtarët për tekste shkollore në Divizionin e Kurrikulave Mësimore nga MASHTI. Takimi është mbajtur me kryetarët e Aktiveve Profesionale të të gjitha shkollave tona për të diskutuar për tekstet shkollore.

Në muajin dhjetor është bërë certifikimi i edukatorëve/eve të komunës sonë, të cilët kanë ndjekur trajnimin “Të nxënësve përmes Përvojës”.

Është shpallur konkursi për ndarjen e bursave për studentët e komunës së Skënderajt për vitin akademik 2025-2026. Për këtë vit do të ndahen 120 bursa në vlerë prej 500 eurosh.

Më 24 dhjetor 2025 ka përfunduar gjysmëvjetori i parë për vitin shkollor 2025-2026.

Sektori për Punë të Përgjithshme Juridike dhe Personel në Arsim

Bazuar në kërkesat e mësimdhënësve drejtuar drejtorisë së Arsimit, Zyra Ligjore kreu këto punë administrative:

- 27 vendime për pushime të lehonisë,
- 4 vendime për pushim pa pagesë,
- 17 vendime për shkëputje të kontratës së punës (pensionistë), si dhe
- 85 vendime të ndryshme të lëshuara nga Drejtoria e Arsimit, si (vendime për shpallje të konkurseve, vendime për transfere të mësimdhënësve, vendime për ndarjen e subvencioneve, vendime për formime të komisioneve etj).
- Po ashtu Zyra Ligjore gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, drejtoi rreth:
- 69 kërkesa të ndryshme, si (kërkesa për MASHT, kërkesa për zyrën e kryetarit, kërkesa zyrës së prokurimit për zhvillimin e procedurave të tenderimit, etj).
- Drejtoria e Arsimit, përshkatësisht Zyra Ligjore shpalli rreth 28 konkurse:
 - për sekretarë/pedagogë/bibliotekist të shkollave,
 - për mësimdhënës dhe
 - për punëtorë teknikë.

Drejtoria e Arsimit, pranon kërkesa të ndryshme nga palët, të cilat janë në kompetencë të Zyrës Ligjore për të kthyer përgjigje dhe gjatë këtyre muajve janë kthyer rreth 36 përgjigje për palë. Kërkesat kanë qenë të ndryshme nga mësimdhënësit për të cilat kanë marrë përgjigje si dhe disa studentë, të cilët kanë kërkuar të mbajnë praktikë profesionale në shkollat e komunës së Skenderajt.

Raporti i zyrës së financave dhe administratës për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2025

Gjatë muajve janar – dhjetor në sektorin e financave dhe të administratës janë kryer punë dhe detyra të shumta sipas planit vjetor të punës në DKA.

Është bërë analizimi i buxhetit për vitin 2025,

Regjistrimi i faturave (komunalive) ujit, rrymës dhe mbeturinave

Është bërë regjistrimi i faturave të operatorëve ekonomik privat

Për çdo muaj janë realizuar ndryshimet në paga për punonjësit e arsimit

Është bërë regjistrimi i borxheve

Është bërë nënalokimi i pagave për çdo muaj dhe nënalokimi i TM1, TM2, TM3, TM4 për mallra shërbime dhe komunal,

Gjithashtu, është bërë zotimi i pagesave dhe kërkesave të shkollave,

Janë bërë përgatitjet e KZB-ve dhe të UOP-ve.

Sipas kërkesave është bërë edhe hapja e ID-ve të furnitorëve.

Ndërsa, në sektorin e administratës janë përfunduar këto punë :

Janë mbyllur të gjitha lëndët e regjistruara në INTRANET (1669 lëndë).

Është bërë pranimi i aplikacioneve të konkursit të fëmijëve në Institucionet Parashkollore “Nëna Zahide” dhe “Sala dhe Hamit Jashari” – Skenderaj si dhe të njëjtat janë regjistruar në platformën elektronike INTRANET.

Gjatë periudhës janar - dhjetor janë mbajtur takime të rregullta me drejtorët e shkollave.

Janë përgatitur kontratat në mënyrë sistematike gjatë vitit, për mësimdhënësit e rinj dhe për ata mësimdhënës të cilët kanë pas ndryshime në kontratat e tyre si dhe është bërë protokolimi i tyre.

Janë protokoluar vërtetimet për mësimdhënësit, të cilët kanë punuar gjatë viteve të 90-ta në shkollat e komunës sonë.

Është bërë përpilimi i listës së nxënësve të shkollave fillore, përfitues të bursave për pagesën e transportit.

Janë vlerësuar procedurat e prokurimit dhe është bërë menaxhimi i kontratave të nënshkruara nga zyra e prokurimit.

Është bërë mbyllja e lëndëve në mënyrë fizike dhe dërgimi i tyre në Arkivën e Komunës .

Drejtori i Arsimit
Kastriot Duraku

